

Njoftim për përqendrim me të cilin Junajted Media S.a r.l., Luksemburg, dhe Motor Oil (Hellas) Korint Refajneris S.A., Atikë, Greqi, fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Nevine Holdings Limited, Nikozija, Qipro dhe Junajted Media S.a r.l., Luksemburg do të fitojë kontroll mbi Martikorio Limited, Qipro

(lënda nr. 08-159/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), më datë 12.12.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë një njoftim për përqendrim me të cilin Junajted Media S.a r.l., me seli të regjistruar në adresën Rue Zhan Mone 6, L-2180, Luksemburg dhe Motor Oil (Hellas) Korint Refajneris S.A., me seli të regjistruar në adresën Irodou Attikou 12a, 151 24 Maroussi, Atikë, Greqi, fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Nevine Holdings Limited, me seli në adresën 66 Akropoleos, Akropolis Tauer, Strovolos 2012, Nikozija, Qipro, si dhe fitimin e kontrollit të pavarur nga ana e shoqërisë Junajted Media S.a r.l., me seli të regjistruar në adresën Rue Zhan Mone 6, L-2180 Luksemburg, mbi shoqërinë Martikorio Limited, me seli në adresën 66 Akropoleos, Akropolis Tauer, Strovolos 2012, Nikozija, Qipro.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Junajted Media S.a r.l., është në pronësi përfundimtare të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimesh ndërkombëtar me seli në Londër. Fondet BC janë investitorë ekskluzivisht financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në menaxhimin e përditshëm të kompanive në të cilat investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners ka prezencë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura indirekte të mëposhtme:

- TOTAL TV SHPK Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/ Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete të shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike përmes platformave teknike DTH,
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Kosta Veselinov nr. 5-1 lokal 2/ Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete marketingu, përkatësisht me blerjen dhe shitjen e hapësirës reklamuese në mediat e shtypura dhe elektronike,
- UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 14, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete të telekomunikacionit satelitor.

Motor Oil (Hellas) Korint Refajneris S.A., është një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Greqisë, e listuar në bursën e Athinës. Motor Oil (Hellas) është aktive në sektorin e përpunimit të naftës. Gjithashtu, përmes shoqërive të saj të varura, është aktive në shitjen e produkteve të naftës si shitja me pakicë dhe shumicë e karburanteve, projektet e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE), menaxhimi i mbetjeve, biokarburantet, etj. Motor Oil (Hellas) është eksportues i produkteve të naftës për pothuajse pesë dekada, ku pjesa më e madhe e prodhimit shitet te blerësit jashtë vendit.

Motor Oil (Hellas) Korint Refajneris S.A., ka shoqëritë e varura të mëposhtme në Maqedoninë e Veriut:

- KORAL-FUELS SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Dimitrija Cupovski nr. 4/2-3, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, aktiviteti prioritar i së cilës është tregtia me produkte të naftës. KORAL-FUELS SHPKNJP Shkup ka licencë për përdorimin e markës SHELL në Maqedoninë e Veriut. Shoqëria menaxhon dy stacione karburanti nën markën SHELL në Maqedoninë e Veriut.

- MOTOR OIL RINJUABLS ENERXHI SHPKNJP Shkup, me seli në adresën Georgi Dimitrov nr.16-1/3 Shkup - Kisela Voda, Maqedonia e Veriut. Aktiviteti prioritar i shoqërisë është tregtia me energji elektrike.

Shoqëritë e synuara Martikorio Limited dhe Nevine Holdings Limited janë shoqëri holding.

Shoqëria kryesore e varur e Shoqërive të synuara është - Alpha Satellite TV S.A., një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Greqisë, me seli në adresën Viltanioti 36, Kifissia, Atikë, Greqi.

Kjo shoqëri është aktive në Greqi në ofrimin e transmetimit televiziv digjital falas të destinuar për informimin e përgjithshëm të zonës greko-folëse. Kjo shoqëri menaxhon kanalin televiziv me emrin "A" (ALPHA).

Gjithashtu, programet e Alpha Satellite TV janë të disponueshme përmes faqes së internetit www.alphatv.gr, si dhe përmes televizionit hibrid HbbTV. Përveç kësaj, kanali televiziv ALPHA transmetohet në rrjetet kablore të operatorëve telekomunikues grekë Nova dhe Cosmote, bazuar në një marrëveshje licence për ritransmetim. Së fundi, një pjesë e programeve televizive të ALPHA TV transmetohen në Qipro.

Asnjë nga Shoqëritë e synuara, duke përfshirë Alpha Satellite TV, nuk është e pranishme dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtruesve të njoftimit, tregu relevant i produkteve për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet si **tregu i prodhimit dhe transmetimit të programeve televizive**.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

26.12.2024

Shkup